

KULTURA 2022



Nr.10

BULETINI MUJOR / TETOR

kultura.gov.al



ART NË HAPËSIRA PUBLIKE, JURIA NDËRKOMBËTARE SHPALL 8 PROJEKTE FITUESE

Në praninë e artistëve, anëtarëve të jurisë, kolegjiut, përfaqësive diplomatike u prezantuan në Ministrinë e Kulturës projektet fituese të Konkursit Ndërkombëtar "Art në Hapësira Publike". Veprat që u zgjodhën mes 132 propozimeve të krijuara nga vende të ndryshme të botës dhe 18 vendndodhjeve të përzgjedhura, do të vendosen në hapësirat e përcaktuara në Malësinë e Madhe, Tiranë, Divjakë e Kavajë. Në këtë edicion të parë, qeveria shqiptare vuri në dispozicion 200 milionë lekë për organizimin dhe mbështetjen e veprave që do të shpallëshin fituese për konkursin. Juria ndërkombëtare zgjodhi vepra fituese, ndërkohë që në listën e veprave të vlerësuara dhe me potencial për t'u zbatuar gjatë vitit që vjen, në të tjera vendndodhje, për të cilat nuk pati konkurrent

ARTISTËT DHE PROJEKTET FITUESE

- Artisti Kristo Krisiko, i cili jeton dhe punon në Athinë, Greqi me projektidenë **"Meteor"**, që do të vendoset në Golem
- Artisti Liu Ruowang nga Tongguan. Shaanxi Province, Kinë me projektidenë **"Wolves Coming"**, që do të implementohet në hyrje të Koplikut
- Artisti Ergys Krisiko, Tiranë, Shqipëri me projektidenë **"Mbërritja e zogjve"**, që do të vendoset te mbikalimi i Pallatit me shigjeta
- Artistja Karolina Halatek nga Lodz, Poloni me projektidenë **"Terminal of Tirana"**, që do të vendoset në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
- Skulptori Sadik Spahia nga Tirana, Shqipëri, me projektidenë **"Zabel"**, që do të vendoset në dalje të Koplikut
- Artistja Blegina Hasko Bezo nga Tirana, Shqipëri, me projektidenë **"Përpjekja e vazhdueshme"**, për t'u vendosur te Mali i Robit, Kavajë
- Artisti Vasil Dhiamandi nga Tirana, Shqipëri, me projektidenë **"Foleza"**, që do të vendoset në rrethrotullimin e Divjakës
- Artisti Alfred Milot Mirashi, Montesarchio, Itali me projektidenë **"Albanian Key"**, që do të vendoset në kryqëzimin e Doganës së Hanit të Hotit

apo vepra të përshtatshme, ose ndërkohë po shqyrtohen gjithë në hapësira të tjera publike sipas ankimmimet e ardhura në adresën e institucioneve publike ose private. e Ministrisë së Kulturës.

PAS RESTAURIMIT HAPËN MUZEU ETNOGRAFIK DHE MUZEU "KADARE"



Muzeu Etnografik dhe Muzeu "Kadare", pjesë e një projekti restaurimi dhe rikonceptimi të sistemit të muzeve në Gjirokastrë, tashmë kanë hapur dyert për vizitorët. Një financim i Bankës Botërore, përmes Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, që përfshinte ndërhyrje restauruese të të gjitha ambienteve të brendshme, çatisë, si dhe rikonstruksionin e jashtëm të objektit, ku është vendosur Muzeu Etnografik, duke e kthyer atë në gjendjen fillestare dhe një vend pritës dhe interesant për turistët e shumtë të Gjirokastrës. Po kështu edhe Muzeu "Kadare", i është nënshtruar muzealizimit sipas standardeve bashkëkohore, ku gjen jo vetëm artefakte dhe veprën e shkrimtarit, por mund të zbulosh më shumë për jetën e tij përmes videoprojeksioneve, audioguidave etj.

"MESSA DA REQUIEM" E VERDIT BËN BASHKË SHQIPËRINË DHE KOSOVËN



Si pjesë e kalendarit të përbashkët artistik Shqipëri e Kosovë, përgjatë dy netëve u ngjiti në skenë "Messa da Requiem", që bëri bashkë artistët të Shqipërisë, Kosovës e ndërkombëtarë. Kjo veper, kompozuar nga Giuseppe Verdi, dirigjuar nga Jacopo Sipari di Pescasseroli, në krye të Orkestrës Simfonike të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Balletit dhe Orkestrës Simfonike të RTSH-së, me solistë: Eva Golemi, Ivana Hoxha, Raffael Abete, Vittorio de Campo, solli një tjetër nivel interpretativ. Në veçanti u duartkorr puna e mrekullueshme nga dirigjentët e korit, Dritan Lumshi e Baki Jashari, që udhëhoqën korin e TKOB-it dhe korin e Filmonisë së Kosovës. Të pranishëm në premierën e kësaj vepre ishin dy ministrat e Kulturës, të Shqipërisë dhe Kosovës, Elva Margariti dhe Hajrulla Çeku.

NIS PUNA PËR RESTAURIMIN E GODINËS SË ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Nisi puna për restaurimin e së godinës së ish-të Përndjekurve Politikë, pjesë e programit EU4CULTURE, zbatuar nga UNOPS. E njohur si godina e ish-të Përndjekurve Politikë, ajo ka shërbyer si selia e Ambasadës Italiane në vitet '30 të shekullit XX. Eleganca e interierëve të asaj kohe është ruajtur akoma pjesërisht dhe qëllimi i restaurimit është të nxjerrë në pah elementet autentike të godinës, duke ruajtur funksionin e tanishëm. Pjesë e restaurimit janë riparimet e dëmeve të tërmetit dhe përmirësimi i të gjitha sistemeve të funksionimit. Fondi i akorduar për restaurimin e kësaj godine simbolike është 600,871 USD.


600,871
USD

ËSHTË FONDI I AKORDUAR PËR RESTAURIMIN E GODINËS SË ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

RESTAURIM DHE RIKONCEPTIM PËR MUZEUN ARKEOLOGJIK TË DURRËSIT, 3 MILIONË USD NGA EU4CULTURE

Muzeu Arkeologjik në Durrës do t'i nënshtrohet restaurimit dhe rikoncepimit muzeal. I përfshirë në programin EU4Culture, ky muze ku ruhen rreth 3 mijë artefakte do të ofrojë kushte bashkëkohore ruajtjeje dhe ekspozimi. Fondi i parashkuar është mbi 3 milionë dollarë.

Gjatë ceremonisë së nisjes së punimeve në Muzeun Arkeologjik, u hap edhe thirrja e dytë e granteve mbështetëse të programit EU4Culture, drejtuar komunitetit lokal në 6 bashki të prekura nga tërmeti i vitit 2019: Tirana, Mirdita (Rubik), Durrësi, Kavaja, Rrogozhina dhe Kruja. Një mundësi zhvillimi ekonomik dhe nxitje për të mësuar dhe përcjellë trashëgiminë tonë jomateriale. Propozimet e përzgjedhura do të marrin fonde që variojnë nga 10,000 deri në 50,000 dollarë. Periudha e parashkuar e zbatimit për çdo projekt do të zgjasë nga 3 deri në 12 muaj.



"TETORI I LIBRIT", MINISTRIA E KULTURËS, DHURIM LIBRASH PËR BIBLIOTEKAT PUBLIKE

I pagëzuar si "Tetori i librit" për shkak të ditëlindjeve të tre kolosëve të letrave shqipe: Gjergj Fishtës, Migjenit dhe Dritëro Agollit, ky muaj u shenjua nga aktivitetet dedikuara librit dhe leximit në të gjithë Shqipërinë: konferenca shkencore, mbrëmje poetike, takime me shkrimtarë, lexime, aktivitete në shkolla etj. Ministria e Kulturës së bashku me Bibliotekën Kombëtare dhuruan libra për disa biblioteka publike në vend. Rreth 140 tituj librash u dhuruan në Bibliotekën Publike "Dritëro Agolli" në Fier, po aq në bibliotekën "Qemal Baholli" në Elbasan dhe rreth 80 tituj në bibliotekën e qytetit të Librazhdit. Bëhet fjalë për vepra të klasikëve tanë dhe atyre botërorë. Fondi i dhuruar nga Biblioteka Kombëtare pasuron më së shumti fondin albanologjik të bibliotekave, pasi bëhet fjalë për botime origjinale të para Luftës II Botërore. Bëhet fjalë për vepra të Kristoforidhit, Fishtës, Frashërlinjve, Poradecit, Kutelit, Spasses, Schiroit, Floqit, Dakos etj. Kjo nismë do të vijojë edhe përgjatë muajit nëntor.

140
TITUJ LIBRASH
U DHURUAN NË BIBLIOTEKËN PUBLIKE "DRITËRO AGOLLI" NË FIER, PO AQ NË BIBLIOTEKËN "QEMAL BAHOLLI" NË ELBASAN